



Arben Durrës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1721 / Prot. 5

Vlorë më, 27 06 2025

VENDIM

Nr. 69, datë 26.06.2025

PËR

**MIRATIMIN PARAPRAK TË LISTËS SË EKSPERTIZAVE DHE SHËRBIMEVE
NDAJ TË TRETËVE DHE TARIFAVE PËRKATËSE TË OFRUARA NGA SEKTORI
I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE NË UV**

Në mbështetje të nenit 38, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma r, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar shkresës nr.1713 prot, datë 25.06.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 26.06.2025,


VENDOSI:


1. Të miratojë paraprakisht listën e ekspertizave dhe shërbimeve ndaj të tretëve dhe tarifave përkatëse të ofruara nga Sektori i kërkimit Shkencor dhe Projekteve sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. ASOC. DENADA SOTA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Nr. 193 Prot.

Vlorë, më 26.06.2025

Lënda: Kërkesës për miratimin e ofrimit të shërbimit të kontrollit të origjinalitetit për palët e treta nëpërmjet platformës Turnitin, programeve *iThenticate* dhe *AI Detection Capabilities*, për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese.

PROF. DR. AURELA SALIAJ
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK TË UV-SË

KËTU

Në mbështetje të kuadrit ligjor dhe institucional në fuqi, konkretisht të VKM-së nr. 777, datë 26.12.2018, e ndryshuar me VKM-në nr. 99, datë 05.02.2020 "*Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore*", Vendimit nr. 62, datë 11.02.2020 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV) "*Për kriteret dhe standardet për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve*". Referuar Rregullores së Brendshme të UV-së, ku përcaktohet domosdoshmëria e përdorimit të programeve kompjuterike të standartizuar për kontrollin e origjinalitetit të punimeve, si dhe Rregullores së Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 06.12.2017.

Ju paraqesim për miratim kërkesën për ofrimin e shërbimit të kontrollit të origjinalitetit për palë të treta (individë apo institucione të interesuara), nëpërmjet përdorimit të programeve kompjuterike *iThenticate* dhe *AI Detection Capabilities*. Këto platforma shërbejnë për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese, duke garantuar standarde të larta të integritetit akademik dhe transparencës shkencore.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e platformës *Turnitin* si instrument që mbështet cilësinë e kërkimit dhe publikimeve shkencore, propozojmë miratimin e ofrimit të këtij shërbimi për palë të treta, në përputhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore të disponueshme, kundrejt tarifave të mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Lloji i ekspertizës, kontroll antiplagjiaturë	Përshkrimi i shkurtuar	Tarifa e propozuar për miratim
Desertacion (doktoratë, PhD)	(analizë citimesh, zbulim teknika mashtruese (white text, karaktere të zëvendësuara), raport originaliteti, AI Detection, ndarje sipas nivelit të dyshimit, mbrojtje të dhënash dhe konfidencialitet)	4000 lekë
Temë diplome		3000 lekë
Artikull shkencor		2000 lekë

Ofrimi i këtij shërbimi synon të forcojë rolin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë si institucion referencë në fushën e kërkimit shkencor dhe të promovojë integritetin akademik në nivel kombëtar. Njëkohësisht, ky shërbim do të kontribuojë në krijimin e të ardhurave shtesë për institucionin, përmes një shërbimi të certifikuar dhe me standard të lartë cilësor për aktorët e jashtëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj,

PËRGJEGJËSE E SEKTORIT

ARTEMIDA LUÇAJ